



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0722

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani kryetare, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik “Shkëlqimi Invest” Sh.P.K. të datës 22.09.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 31.08.2023 të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Gjakovës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Molerimi i shkollave - faza II” me numër të prokurimit 632-23-7841-2-2-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë 11.11.2023 merr këtë:

Vendim

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik “Shkëlqimi Invest” Sh.P.K. me nr. 2023/0722 e datës 22.09.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 31.08.2023 të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Gjakovës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Molerimi i shkollave - faza II” me numër të prokurimit 632-23-7841-2-2-1.
2. Vërtetohet, Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Gjakovës të datës 17.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Molerimi i shkollave - faza II” me numër të prokurimit 632-23-7841-2-2-1. Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 27,500.00 €.

Me datë 31.08.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 së bashku me letrën standarde për tenderuesin e eliminuar përmes të cilit është eliminuar si i papërgjegjshëm operatori ekonomik ankues.

Me datë 04.09.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 12.09.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues. Operatori ekonomik ankues me datë 22.09.2023 ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 2023/0722.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim: *“Ne ofertë kemi listuar 11 punëtor të përshkruar me kualifikime në listë të kontratave, ndërsa AK thotë që nuk e kemi plotësuar numrit e kërkuar. Në kërkesë shihet që AK ka kërkuar 10 punëtor, ndërsa ne kemi dorëzuar në listë 11 puntor, dy nga të cilët i kanë kualifikimet siç i ka kërkuar AK, inxhinier i ndërtimtarisë dhe i arkitekturës. AK në letrën standarde për eliminim e ka cekur se nuk kemi sjell dëshmi të stafit, por AK nuk e ka shfrytëzuar aspak LPP dhe rregulloren e prokurimit për të kërkuar sqarime shitesë siç e thotë edhe ligji. I njëjti rast për një lëndë tjetër është trajtuar në OSHP, një AK tjetër e ka eliminuar ofertën tonë për të njëjtën arsye dhe pas ankesës tonë jepet vendimi i OSHP në favor të Shkelqimi Invest, me udhëzimin që në rivlerësim të kërkohej sqarimet e duhura me letër standarde. Bëhet fjalë për vendimin me nr. 667/22, ku mund ta vlerësoni si rast të njëjtë”.*

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59 dhe 60 të LPP. Operatori ekonomik ankues ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues që të miratohet ankesa ashtu që të kthehet lënda në Rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 26.09.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 06.10.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: *“ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa vendimi i AK-së të mbetet në fuqi”.*

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat tjera që janë propozuar nga palët.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues në raportin e ekspertit shqyrtues janë evidentuar vlerësimet si në vijim: “Sipas DT është kërkuar që të dorëzojnë një listë me së paku 10 punëtor teknik si dhe dy staf profesional, përfshirë një inxhinier të ndërtimtarisë dhe një të arkitekturës. Në listën e punëtorëve të dorëzuar nga OE ankues, figurojnë 11 punëtor gjithsej, duke i përfshirë edhe dy nga stafi profesional. Sipas ekspertit shqyrtues OE ankues nuk e ka përmbushur kriterin e DT për numrin e punëtorëve të kërkuar, veç kësaj po ashtu për stafin profesional është kërkuar që për të njëjtit të dorëzohen si dëshmi CV, diploma dhe kontratat e punës. OE ankues ka dërguar vetëm listën e punonjësve por jo edhe dëshmi të tjera të cilat janë kërkuar në këtë aktivitet prokurimi, përkatësisht nuk ka dorëzuar asgjë nga dëshmitë e kërkuara për stafin profesional. Duke u bazuar në nenin 72 të Ligjit për Prokurim Publik, edhe pse mos dorëzimi i asnjë dëshmie për stafin sipas kërkesave të DT, tregon një joseriozitet të vet Operatorit Ekonomik, prapë AK është dashur që të kërkojë sqarime shitesë në bazë të këtij neni, sa i përket dokumenteve të cilat mungojnë për stafin profesional të prezantuar në listë, me kushtin që ato të mund të vërtetohen në mënyrë objektive që kanë ekzistuar para datës së skadimit për dorëzim të ofertave. Po ashtu edhe sipas Udhëzuesit të Prokurimit, në rast se mungojnë informata të caktuara si CV apo dokumente të tjera dëshmuuese për stafin relevant, AK mund të kërkojë sqarime shitesë. Ndërsa sa i përket listës me një punëtor më pak, mendimi i ekspertit shqyrtues është se një listë e punonjësve nga AK është e vështirë të vërtetohet në mënyrë objektive se ka ekzistuar edhe më parë se dita e fundit e dorëzimit të ofertave, ashtu siç e kërkon edhe neni 72 i LPP. Duke u bazuar në atë çfarë u sqarua më lartë, eksperti shqyrtues konsideron që Operatori Ekonomik është dashur të qëndroj i përgjegjshëm ndaj kërkesave të DT, në këtë rast Autoriteti Kontraktues nuk mund të përdorë nenin 72 të LPP për të kërkuar sqarime shitesë të shtimit të numrit të punëtorëve sepse një gjë e tillë do të përbënte ndryshim të ofertës, por edhe nëse AK do të bënte një veprim të tillë përkundrejtë ligjit, kjo situatë nuk do të ndryshonte asgjë për faktin se lista e re e punëtorëve, me një punëtor më shumë e cila do të dorëzohej, është e pamundur të vërtetohet se ka ekzistuar edhe më parë. Andaj ky pretendim i ngritur nga OE ankues vlerësojmë se është pjesërisht i bazuar. Por, duke marrë parasysh se edhe kthimi i lëndës në rivlerësim nuk do të ndryshonte asgjë për faktin se prapë nuk do të përmbushej kushti i numrit të punëtorëve atëherë eksperti vlerëson se duhet të mbetet në fuqi vendimi i AK”.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues. Argumentimi i ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP si dhe rregullores së punës në OSHP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë të gjitha konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

Kërkesa e dosjes së tenderit të cilës i referohen pretendimet ankimore është formuluar si në vijim *“Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 10 (dhjetë) punëtorë të mjaftueshëm si dhe të ketë staf profesional për kryerjen e projektit a.) një inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv me pesë vite përvojë pune pas diplomimit, b.) një inxhinier i diplomuar apo master i arkitekturës me pesë vite përvojë pune pas diplomimit”*. Ndërsa dëshmia dokumentare e kërkuar për këtë kërkesë është parashtruar si në vijim *“Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë, si dhe lista e numrit të punëtorëve të angazhuar me të dhënat në vijim emri, mbiemri i/e punëtorit, profesioni dhe pozicioni në kompani”*.

Nga letra standarde për tenderuesin e eliminuar por edhe nga dosja me të cilën ka ofertuar parashtruesi është gjetur se parashtruesi nuk ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara dokumentare për stafin me të cilin ka tenderuar. Ky fakt nuk është kontestues pasi që edhe parashtruesi në ankesën e tij nuk e kundërshton arsyen për eliminim si të pasaktë mirëpo potencon se ‘AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë’. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka gjetur se as për vet operatorin ekonomik ankues nuk është kontestues fakti që nuk janë dorëzuar të gjitha dëshmitë e kërkuara dokumentare mirëpo pretendimi i ankuesit është se Autoriteti Kontraktues në këtë rast është dashur që të kërkojë sqarime shtesë në kuptim të nenit 72 të LPP. Lidhur me këtë çështje Paneli Shqyrtues i ka falur besimin konstatimit të ekspertit shqyrtues ku thuhet se *“Operatori Ekonomik është dashur të qëndroj i përgjegjshëm ndaj kërkesave të DT, në këtë rast Autoriteti Kontraktues nuk mund të përdor nenin 72 të LPP për të kërkuar sqarime shtesë të shtimit të numrit të punëtorëve sepse një gjë e tillë do të përbënte ndryshim të ofertës, por edhe nëse AK do të bënte një veprim të tillë përkundrejt ligjit, kjo situatë nuk do të ndryshonte asgjë për faktin se lista e re e punëtorëve, me një punëtor më shumë e cila do të dorëzohej, është e pamundur të vërtetohet se ka ekzistuar edhe më parë”*. Rrjedhimisht edhe Paneli Shqyrtues konsideron se sqarimet shtesë në këtë rast do të përbënin ndryshim material të ofertës pasi që nuk bëhet fjalë për informacione shtesë lidhur me një dokument të ofertuar por bëhet fjalë për dorëzimin e dokumenteve të cilat janë kërkuar me dosjen e tenderit dhe të cilat është dashur të dorëzohen me rastin e ofertimit.

Nga sa u tha më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin edhe konstatimit tjetër të ekspertit shqyrtues të cituar nga raporti i ekspertit si në vijim *“duke marrë parasysh se edhe kthimi i lëndës në rivlerësim nuk do të ndryshonte asgjë për faktin se prapë nuk do të përmbushej kushti i numrit të punëtorëve atëherë eksperti vlerëson se duhet të mbetet në fuqi vendimi i ”*. Nuk mundet AK të kërkojë sqarim shtesë kur OE nuk e plotëson numrin e kërkuar të punëtorëve. Sqarimet shtesë do të ishin lejuar nëse OE ka plotësuar numrin e kërkuar të punëtorëve por ndonjë dëshmi eventuale që deshmon angazhimin apo përvojën e tyre mungon. OE duhet të kenë parasysh se janë të obliguar dhe përgjegjës po ashtu të ofertojnë konform kërkesave të DT, pa nevojë që të plotësohen ofertat e tyre me dokumente të cilat sipas kujdesit të vetë OE duhet të jenë të paraqitura me kohë në ofertën e tyre.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve

ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet si pjesërisht e bazuar. Megjithatë duke u mbështetur në sqarimet dhe argumentet e evidentuara nga eksperti shqyrtues, Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Gjakovës të datës 31.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Molerimi i shkollave - faza II” me numër të prokurimit 632-23-7841-2-2-1.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veprojnë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të iniciojë procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP. Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 par. 4 dhe par. 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - Shkelqimi Invest SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: